



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1015/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Bahrije Ademi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1015/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për antare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Bahrije Ademi nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë. paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 2701B/01R, 2702B/01R, 2702B/05D, 2702X/03R, 2702X/05D, 2705B/01D, 2717B/03D, 2727B/01R, 2727B/02D, 2709B/01R, 2709B/02R, 2711B/01R, 2711B/02D, 2730B/02D, 2718B/01D, 2730B/01R, 2704B/05R, 2704/07R, 2704B/09R, 2704B/12R, 2704B/14D, 2710B/01R, 2710B/02R, 2710B/03R, 2731B/01R, 2731B/02D, 2726B/01D, 2707B/01R, 2707B/03D, 2712B/02R, 2712B/03D, 2729B/01R, 2729B/02R, 2721B/01R, 2721B/02D, 2714B/01R, 2714B/02R, 2714B/03R, 2714B/04D, 2706B/01R, 2706B/02D, 2708B/01R, 2708B/02D, 2713B/02R, 2713B/03R, 2713B/04R, 2713B/05D, 2729B/03D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga , Bahrije Ademi ,kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se në vendvotimet: 2701B/01R, 2702B/01R, 2702B/05D, 2702X/03R, 2702X/05D, 2705B/01D, 2717B/03D, 2727B/01R, 2727B/02D, 2709B/01R, 2709B/02R, 2711B/01R, 2711B/02D, 2730B/02D, 2718B/01D, 2730B/01R, 2704B/05R, 2704/07R, 2704B/09R, 2704B/12R, 2704B/14D, 2710B/01R, 2710B/02R, 2710B/03R, 2731B/01R, 2731B/02D, 2726B/01D, 2707B/01R, 2707B/03D, 2712B/02R, 2712B/03D, 2729B/01R, 2729B/02R, 2721B/01R, 2721B/02D, 2714B/01R, 2714B/02R, 2714B/03R, 2714B/04D, 2706B/01R, 2706B/02D, 2708B/01R, 2708B/02D, 2713B/02R, 2713B/03R, 2713B/04R, 2713B/05D, 2729B/03D, ka pasur manipulim të votave.

Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara lidhur me mungesën e votave të sajë, dhe pasqyrimin jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje apo mungesë të votave të parashtruesit të apelit, për faktin se thëniet e saja nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Bahrije Ademi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga subjekti politik LVV, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë regjistrimit të votave për kandidaten dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Bahrije Ademi nga subjekti politik LVV, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1015/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Paneli

Milena Deric

Milena



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.